

BASHKIA LUSHNJE
NJOFTIM ANKANDI

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia Lushnje
Adresa	Lagjia :” Kongresi i Lushnjes “ Lushnje
Tel/Fax	+ 355 35 221 39
E-mail	bashkia_lushnje@yahoo.com
Adresa e Internetit	www.bashkialushnje.gov.al

2. Emri dhe adresa e personit përgjegjës:

Emri	Ariola Korreshi
Adresa	Drejtori i Përgjithshëm i Integritetit, Politikave Sociale dhe Informimit
Tel/Fax	+355 693 656 426
E-mail	ariola.korreshi@bashkialushnje.gov.al

3. Data e zhvillimit të ankandit : 01.09.2025 ora 10.00

4. Lloji i procedurës standarte të ankandit : Procedure e hapur

5. Objekti i shitjes : Shitje me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Lushnja 1930” shane masen 100% .

6. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes

KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930 sh.a është krijuar më 06.09.2013 me Vendim Nr.60 të Këshillit të Bashkisë Lushnje, si një shoqëri aksionare me ofertë private. KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930 sh.a ka selinë në Lagjia “Xh.Nepravishta” në stadiumin Roza Haxhiu, Lushnje.

Futbolli ka një histori suksesi 94-vjeçare për Qytetin e Lushnjes. Klubi Futbollit Lushnja (KF Lushnja) u themelua më 27 korrik 1930 në Lushnje. Aksionet zotërohen 100% nga Bashkia Lushnje

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë KLUBI I FUTBOLLIT LUSHNJA 1930 sh.a është: Organizimi i aktiviteteve sportive të futbollit; krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit; aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare; Futja në tregun e lojtarëve për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit; aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë; Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

7. Vlera e ankandit do të jetë 11 261 652,80 (njemdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy presje tetëdhjetë) Leke.

Vlera fillestare e ankandit ishte 14 077 066 (katërmëdhjetë milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

Objekti i Ankandit është shpallur dy herë për shitje, por në asnjë nga të dyja heret, nuk është paraqitur asnjë ofertë për blerjen e tij.

Në zbatim të VKM -se nr.1719 dt.17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” të ndryshuar, Kreu VI Kushte të Pergjithshme për zbatim, pika 6, Mungesa e Konkurrencës, shkronja c, Autoriteti shites beri ndryshimin e vlerës në masën 20%.

8. Vendi i zhvillimit të ankandit (Adresa): Salla e mbledhjeve kati 2, Bashkia Lushnje.

9. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 01.09.2025 ora 10.00

10. Informacion mbi dokumentet e ankandit :

Dokumentet e ankandit mund të terhiqen pranë Autoritetit Shites.

Dokumente me pagesë:

Po ☐ Jo ☒ X

Dokumentet standarte të ankandit përbehen nga :

- Formulari i njoftimit
- Kërkesa për pjesëmarrje
- Formulari i ofertes
- Ftesa për ofertë
- Formulari i njoftimit të fituesit

- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit
- Procesverbali /et i/e Komisionit te Vleresimit te Ofertave .

11.Kerkesa per pjesemarrje , dokumentet dhe informacionet e kerkuara dorezohen nga kandidatet bleres ne kopje fizike , me p;oste ose dorazi , ne vendin e percaktuar ne dokumentet e ankandit.